

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2010), dhe nenet 19 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucioneve Financiare Jo-Bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 04 gusht 2022, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TREGUESIN E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM NETO

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë qëndrueshmërinë e bankës për një periudhë më të gjatë kohore duke vendosur kriteret për kalkulimin e kërkesës për financimin e qëndrueshëm neto si dhe nivelin minimal të Treguesit të Financimit të Qëndrueshëm Neto, për të siguruar që bankat mbajnë një profil të financimit të qëndrueshëm në raport me asetet dhe zërat jashtëbilancorë të tyre.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (më tutje: BQK) për të operuar në Republikën e Kosovës, përfshirë degët të bankave të huaja.

Neni 2

Përkufizimet

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe, të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë sikurse përkufizohen në Ligjin Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat); Rregulloren e BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave si dhe Rregulloren e BQK-së mbi Treguesin e Mbulimit me Likuiditet; dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregullore:
 - 1.1. **Ndëshkim material** – përfshinë humbjen e interesit ndërmjet datës së tërheqjes dhe maturitetit kontraktual të depozitës plus një gjobë materiale që nuk duhet të tejkalojë interesin e pagueshëm për kohën që ka kaluar ndërmjet datës së depozitimit dhe datës së tërheqjes;
 - 1.2. **Depozita në të parë** – depozita në të parë nënkupton të gjitha depozitat në para të gatshme të cilat mund të tërhiqën, pa paralajmërim, në çdo kohë;
 - 1.3. **Vlera fer e setit të netimit (ang. Netting set)** – shumën e vlerave fer të të gjitha transaksioneve të përfshira në atë set netimi.

KAPITULLI I

TREGUESI I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM NETO

Neni 3

Aplikimi në bazë të konsoliduar

1. Në rastet kur treguesi i financimit të qëndrueshëm neto (më tutje: treguesi NSFR - Net Stable Funding Ratio) i përcaktuar sipas kësaj rregulloreje aplikohet në bazë të konsoliduar, aplikohen dispozitat si në vijim:
 - 1.1. asetet dhe zërat jashtë-bilancorë të subjektit të varur, që vepron me selinë kryesore në shtetin e huaj, të cilat i nënshtrohen faktorëve të financimit të qëndrueshëm të kërkuar (më tutje: RSF - *Required Stable Funding*) të përcaktuar sipas Legjislacionit të shtetit të huaj e që janë më të larta se ato të specifikuara në Kapitullin IV të kësaj rregulloreje, duhet t'i nënshtrohen konsolidimit në pajtueshmëri me faktorët më të lartë të përcaktuar sipas legjislacionit të këtij shteti të huaj;
 - 1.2. detyrimet dhe kapitali rregullator të subjektit të varur, që vepron me selinë kryesore në shtetin e huaj, të cilat i nënshtrohen faktorëve të financimit të qëndrueshëm në dispozicion (më tutje: ASF - *Available Stable Funding*) të përcaktuar sipas Legjislacionit të shtetit të huaj e që janë më të ulëta se ato të specifikuara në Kapitullin III të kësaj rregulloreje, duhet t'i nënshtrohen konsolidimit në pajtueshmëri me faktorët më të ulët të përcaktuar sipas legjislacionit të këtij shteti të huaj;
 - 1.3. asetet e shtetit të huaj që janë në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në rregulloren e BQK-së për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet dhe që mbahen nga subjekti i varur me selinë kryesore në shtetin e huaj, nuk duhet të njihen si asete likuide për qëllime të konsolidimit nëse këto nuk kualifikohen si asete likuide sipas legjislacionit që përcakton kërkesat e mbulimit me likuiditet të këtij shteti të huaj.

Neni 4

Treguesi i financimit të qëndrueshëm neto

1. Kërkesa për financim të qëndrueshëm neto duhet të jetë e barabartë me raportin në mes të shumës së financimit të qëndrueshëm në dispozicion të bankës (më tutje: ASF), siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj rregulloreje, ndaj shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar të bankës (më tutje: RSF), siç është përcaktuar në Kapitullin IV të kësaj rregulloreje, dhe duhet të jetë e shprehur në përqindje. Bankat duhet të kalkulojnë treguesin e tyre NSFR sipas formulës në vijim:

$$\frac{\text{Shuma e financimit të qëndrueshëm në dispozicion(ASF)}}{\text{Shuma e financimit të qëndrueshëm të kërkuar(RSF)}} \geq 100\%$$

2. Bankat duhet të mbajnë treguesin e tyre të financimit të qëndrueshëm neto prej së paku njëqind përqind (100%), i llogaritur në valutën raportuese për të gjitha transaksionet e tyre pavarësisht nga denominimi i valutës aktuale të tyre.

3. Nëse treguesi NSFR i bankës ka rënë nën njëqind përqind (100%), apo vlerësohet me arsyeshmëri se do të bie nën njëqind përqind (100%), banka menjëherë duhet të njoftojë BQK-në dhe duhet t'i paraqesë pa vonesë të panevojshme një plan të rikthimit të pajtueshmërisë me kërkesën nga paragrafi 2 i këtij Neni. BQK do të vlerësojë arsyet e mospajtueshmërisë së bankës me paragrafin 2 të këtij Neni dhe mund të ndërmerë masa administrative sipas Ligjit për Bankat.
4. Bankat duhet të kalkulojnë dhe monitorojnë treguesin e tyre të financimit të qëndrueshëm neto në valutën raportuese për të gjitha transaksionet e tyre, pavarësisht nga valuta aktuale që përdorin si dhe veçmas për secilën valutë për transaksionet e tyre në valuta tjera nëse raportimi në valuta tjera është në pajtueshmëri me udhëzime të përcaktuara nga BQK-ja.
5. Bankat duhet të sigurojnë që shpërndarja e profilit të tyre të financimit sipas valutës është në përgjithësi në përputhje me shpërndarjen e aseteve të tyre në bazë të valutës. BQK mund të kërkojë që bankat të kufizojnë mospërputhjet valutore (ang. currency mismatches) duke përcaktuar kufizime në pjesën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar për një valutë të veçantë që mund të plotësohet nga financimi i qëndrueshëm në dispozicion që nuk është denominuar në atë valutë. Ky kufizim mund të zbatohet vetëm për një valutë që është subjekt i raportimit të veçantë në pajtim me udhëzime të përcaktuara nga BQK.
6. Në përcaktimin e nivelit të çdo kufizimi në mospërputhjet valutore që mund të përdoren në pajtueshmëri me këtë nen, BQK do të konsiderojë së paku:
 - 6.1. nëse banka ka aftësi të transferojë financimin e qëndrueshëm në dispozicion nga një valutë në valutën tjetër dhe në juridiksionet dhe entitetet ligjore brenda grupit të saj si dhe aftësinë për të kundërkëmbyer valuta dhe t'i mbledhë fondet nga tregjet valutore të huaja gjatë periudhës një-vjeçare të treguesit të financimit të qëndrueshëm neto;
 - 6.2. ndikimin e lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit në pozicionet ekzistuese të papërputhura dhe në efektivitetin e çdo mbrojtjeje të këmbimit të valutës së huaj që ekziston.

KAPITULLI II

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR KALKULIMIN E TREGUESIT TË FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM NETO

Neni 5

Kalkulimi i treguesit të financimit të qëndrueshëm neto

1. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë rregullore, bankat gjatë kalkulimit duhet të marrin parasysh vlerën bruto të aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë-bilancor të tyre.
2. Për qëllime të kalkulimit të treguesit NSFR të tyre, bankat duhet të aplikojnë faktorët e përshtatshëm të financimit të qëndrueshëm, të përcaktuar në Kapitujt III dhe IV të kësaj rregulloreje, në vlerën kontabël të aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë-bilancor të tyre përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë rregullore.
3. Bankat nuk duhet të llogarisin dyfish shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar (RSF) dhe shumën e financimit të qëndrueshëm në dispozicion (ASF). Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë rregullore, kur një zë mund të alokohet në më shumë se një kategori të RSF, ky zë duhet t'i

alokohet kategorisë RSF nga e cila rrjedh një obligim më i gjatë kontraktual i financimit të qëndrueshëm të kërkuar për atë zë.

Neni 6

Kontratat e derivativëve

1. Bankat duhet të zbatojnë këtë nen për të kalkuluar shumën RSF për kontratat e derivativëve siç përcaktohet në Kapitujt III dhe IV të kësaj rregullore.
2. Bankat duhet të marrin parasysh vlerën fer të pozicioneve të derivativëve sipas bazës neto aty ku këto pozicione janë të përfshira në të njëjtin set netimi (ang. netting set). Kur kërkesa e mëhershme e këtij paragrafi nuk është e aplikueshme atëherë, bankat duhet të marrin parasysh vlerën fer të pozicioneve të derivativëve sipas bazës bruto dhe duhet t'i trajtojnë ato pozicione sikurse t'i përkisnin setit të netimit të vet për qëllime të Kapitullit IV të kësaj rregullore.
3. Të gjitha kontratat e derivativëve të listuara në nënparagrafet 2.1 deri 2.5 të Aneksit II të kësaj rregulloreje, që përfshijnë shkëmbimin e plotë të shumave të principalëve në të njëjtën datë, duhet të kalkuloohen mbi bazën neto në mes të valutave, përfshirë valutën që është subjekt i raportimit të ndarë, edhe kur ato transaksione nuk janë të përfshira në të njëjtin set netimi.
4. Paraja e gatshme e pranuar si kolateral për të zvogëluar ekspozimin e pozicionit të derivativit duhet të trajtohet ashtu siç është dhe nuk duhet të trajtohet si depozitë siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj rregullore.

Neni 7

Netimi i transaksioneve të financuara me letrat me vlerë dhe transaksioneve të bazuara nga tregjet e kapitalit

1. Bankat mund të kalkulojnë vlerën e ekspozimit të parasë së gatshme të arkëtueshme dhe parasë së gatshme të pagueshme në transaksionet e financuara me letrat me vlerë me një kundërpalë të njëjtë në bazën neto vetëm atëherë kur të gjitha kushtet në vijim janë plotësuar:
 - 1.1. transaksionet kanë të njëjtën datë përfundimtare të shlyerjes;
 - 1.2. e drejta për të shlyer shumën që i detyrohet kundërpalës me shumën që kundërpala detyrohet është ligjërisht e zbatueshme në rrjedhën normale të biznesit si dhe në raste të dështimit, josolvencës dhe falimentimit;
 - 1.3. kundërpalët synojnë të shlyejnë në baza neto ose të shlyejnë njëkohësisht, ose transaksionet janë subjekt i një mekanizmi të shlyerjes që rezulton në një funksion që është i barabartë me shlyerjen neto.

KAPITULLI III
FINANCIMI I QËNDRUESHËM NË DISPOZICION PËR KALKULIMIN E TREGUESIT
NSFR

NËNKAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 8

Kalkulimi i shumës së financimit të qëndrueshëm në dispozicion

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Kapitull, shuma e ASF duhet të kalkulohet duke shumëzuar vlerën kontabël të kategorive të ndryshme të detyrimeve dhe kapitalit me shumën faktorëve të ASF të definuara në Nënkapitullin II të këtij Kapitulli. Shuma totale e ASF është shuma e shumave të peshuara të detyrimeve dhe kapitalit.
2. Obligacionet dhe letrat tjera me vlerë të borxhit të emetuara nga banka, të shitura ekskluzivisht në tregun me pakicë (ang. retail market), dhe të cilat mbahen në llogari me pakicë (ang. retail account), mund të trajtohen sikurse të jenë pjesë e kategorisë së përshtatshme të depozitave me pakicë (ang. retail deposits). Kufizimet duhet të përcaktohen nga banka, në mënyrë që të ndalohet blerja e tyre dhe mbajtja nga klientët tjere përveç atyre me pakicë (ang. retail).

Neni 9

Maturiteti i mbetur i detyrimit apo kapitalit rregullator

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Kapitull, bankat duhet të marrin parasysh maturitetin e mbetur kontraktual të detyrimeve dhe kapitalit të tyre për të përcaktuar faktorët ASF gjatë aplikimit sipas Nënkapitullit II të këtij Kapitulli.
2. Bankat duhet të marrin parasysh kontratat ekzistuese të opsioneve gjatë përcaktimit të maturitetit të një detyrimi apo kapitalit të saj. Bankat gjithashtu duhet të marrin parasysh supozimet se kundërpala do të riblejë opsionet në blerje në datën më të hershme të mundshme. Për kontratat e opsioneve të ekzekutueshme në diskrecion të bankës, banka duhet të merr parasysh faktorët reputacional që mund të ndikojnë në kufizimin e aftësisë së bankës për të mos ekzekutuar kontratën e opsionit, në veçanti pritjet e tregut që bankat duhet t'i riblejnë disa detyrime para maturitetit të tyre.
3. Bankat duhet t'i trajtojnë depozitat me kohë të përcaktuar të njoftimit sipas kësaj kohe të përcaktuar të njoftimit dhe duhet t'i trajtojnë depozitat me afat në pajtueshmëri me maturitetin e mbetur. Duke e përjashtuar paragrafin 2 të këtij Neni, bankat nuk duhet të marrin parasysh mundësinë e tërheqjes së hershme edhe atëhere kur depozituesi duhet të paguaj një ndëshkim material për shkak të tërheqjeve të hershme të cilat ndodhin brenda periudhës një (1) vjeçare.
4. Për të përcaktuar faktorët ASF të cilat duhet të aplikohen sipas Nënkapitullit II të këtij Kapitulli, për detyrimet me maturitet të mbetur kontraktual prej një viti apo më shume, çdo pjesë që matoron për më pak se gjashtë (6) muaj dhe çdo pjesë që matoron nga gjashtë (6) muaj deri në një (1) vit, duhet të trajtohet si maturitet i mbetur për më pak se gjashtë (6) muaj si dhe maturitet i mbetur për gjashtë (6) muaj deri më pak se një (1) vit, respektivisht.

NËNKAPITULLI II FAKTORËT E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM NË DISPOZICION

Neni 10

Faktori ASF prej zero përqind (0%)

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Nënkapitull, të gjitha detyrimet që nuk kanë maturitet të përcaktuar, përfshirë pozicionet e shkurta (ang. short positions) dhe pozicionet me maturitet të hapur, janë subjekt i faktorit ASF prej zero përqind (0%), me përjashtim të:
 - 1.1. detyrimeve tatimore të shtyra, të cilat duhet të trajtohen sipas datës më të afërt në të cilën detyrime të tilla mund të realizohen;
 - 1.2. Interesit pakicë, që duhet të trajtohet sipas kohëzgjatjes së instrumentit në fjalë.
2. Detyrimet tatimore të shtyra dhe interesi pakicë të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni janë subjekt i faktorëve si në vijim:
 - 2.1. zero përqind (0%) kur maturiteti efektiv i mbetur i detyrimit tatimor të shtyrë apo interesit pakicë është më pak se një (1) vit; dhe
 - 2.2. njëqind përqind (100%) kur maturiteti efektiv i mbetur i detyrimit tatimor të shtyrë apo interesit pakicë është një (1) vit apo më shumë.
3. Detyrimet në vijim janë subjekt i faktorit ASF prej zero përqind (0%):
 - 3.1. të pagueshmet sipas datës së tregtimit që rrjedhin nga blerjet e instrumenteve financiare, valutave të huaja dhe mallrave (ang. commodities), që pritet të shlyhen brenda ciklit standard të shlyerjes apo periudhës që është normale për këmbimin përkatës apo llojit të transaksionit, ose që kanë dështuar të shlyhen por pritet të shlyhen;
 - 3.2. detyrimet me maturitet të mbetur prej më pak se një (1) viti të ofruara nga:
 - 3.2.1. BQK;
 - 3.2.2. Banka Qendrore Europiane (BQE) apo Banka Qendrore e një shteti të huaj;
 - 3.2.3. Klientet financiarë;
 - 3.3. çdo detyrim tjetër dhe zë apo instrument i kapitalit që nuk është përcaktuar në këtë nen apo nenet 11 deri 14 të kësaj rregullore.
4. Bankat duhet të aplikojnë faktorin ASF prej zero përqind (0%) ndaj vlerës absolute të diferencës, nëse është negative, në mes të shumës së vlerave fer të të gjithë seteve të netimit me vlerën fer pozitive dhe shumës së vlerave fer të të gjitha seteve të netimit me vlerën fer negative të kalkuluara sipas Nenit 6 të kësaj rregullore.
5. Rregullat në vijim duhet të aplikohen gjatë kalkulimit të referuar në paragrafin 4 të këtij neni:
 - 5.1. margjina ndryshuese (ang. variation margin) që bankat kanë pranuar nga kundërpalët e tyre duhet të zbritet nga vlera fer e setit të netimit me vlerën fer pozitive kur kolaterali i pranuar si margjinë ndryshuese kualifikohet si aset i Nivelit një (1), të përcaktuar në rregulloren e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, dhe kur bankat kanë të drejtë ligjore dhe operationale të ripërdorin atë kolateral;

5.2. të gjitha margjinat ndryshuese të postuara nga bankat te kundërpalët e tyre do të zbriten nga vlera fer e setit të netimit me vlerën fer negative.

Neni 11

Faktori ASF prej pesëdhjetë përqind (50%)

1. Detyrimet në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit ASF prej pesëdhjetë përqind (50%):
 - 1.1. depozitat e pranuar që plotësojnë kriteret për depozita operacionale, të përcaktuara në Nenin 21 të Rregullorës së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet;
 - 1.2. detyrimet me maturitet të mbetur prej më pak se një viti të ofruara nga:
 - 1.2.1. Qeveria e Republikës së Kosovës apo Qeveri Qendrore e shtetit të huaj;
 - 1.2.2. Qeveritë regjionale apo autoritetet lokale të një shteti të huaj;
 - 1.2.3. Entitetet e sektorit publik të Qeverisë së Kosovës apo të një shteti të huaj;
 - 1.2.4. Bankat shumëpalëshe të zhvillimit të përcaktuara në paragrafin 3 të Nenit 47 dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në Nenin 48 të Rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
 - 1.2.5. korporatat jo-financiare;
 - 1.2.6. unionet kreditore, kompanitë të investimeve private dhe klientët që janë brokerë të depozitave, me përjashtim të depozitave të pranuar, që plotësojnë kriteret për depozita operacionale të përcaktuara në Nenin 21 të Rregullorës së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet.

Neni 12

Faktori ASF prej nëntëdhjetë përqind (90%)

1. Depozitat në të parë me pakicë (ang. sight retail deposits), depozitat me pakicë (ang. retail deposits) me periudhë të përcaktuar të njoftimit prej më pak se një (1) viti si dhe depozitat me pakicë (ang. retail deposits) me afat, me maturitet të mbetur prej më pak se një (1) viti që plotësojnë kriteret relevante për depozitat tjera me pakicë, të përcaktuar në nenin 20 të Rregullorës së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, duhet të jenë subjekt i faktorit ASF prej nëntëdhjetë përqind (90%).

Neni 13

Faktori ASF prej nëntëdhjetë e pesë përqind 95%

2. Depozitat me pakicë (ang. retail deposits) në të parë, depozitat me pakicë (ang. retail deposits) me periudhë të përcaktuar të njoftimit prej më pak se një (1) viti si dhe depozitat me pakicë (ang. retail deposits) me afat, me maturitet të mbetur prej më pak se një (1) viti që plotësojnë kriteret relevante për depozitat e qëndrueshme me pakicë, të përcaktuar në nenin 19 të Rregullorës së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, duhet të jenë subjekt i faktorit ASF prej nëntëdhjetë e pesë përqind (95%).

Neni 14
Faktori ASF prej njëqind për përqind (100%)

1. Detyrimet, zërat dhe instrumentet e kapitalit në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit ASF prej njëqind për përqind (100%):
 - 1.1. zërat e kapitalit bazë të klasës të parë të bankës para aplikimit të përshtatjeve rregullative të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe nenet 30 deri 36 të Rregullorës së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave dhe paragrafit 6 të nenit 47 të Ligjit për Bankat;
 - 1.2. zërat e kapitalit shtesë të klasës së parë të bankës para aplikimit të përshtatjeve rregullative të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe nenet 30 deri 36 të Rregullorës së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave dhe paragrafit 6 të nenit 47 të Ligjit për Bankat, me përjashtim të instrumenteve me opsione eksplicite dhe të përfshira (ang. embedded) që, nëse ekzekutohen, do të zvogëlojnë maturitetin efektiv të mbetur në më pak se një (1) vit;
 - 1.3. zërat e kapitalit të klasës së dytë të bankës para aplikimit të përshtatjeve rregullative të përcaktuara në nenet 20, 21 dhe nenet 30 deri 36 të Rregullorës së BQK-së për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave dhe paragrafit 6 të nenit 47 të Ligjit për Bankat, me përjashtim të instrumenteve me opsione me eksplicite dhe të përfshira (ang. embedded) që, nëse ekzekutohen, do të zvogëlojnë maturitetin efektiv të mbetur në më pak se një (1) vit;
 - 1.4. çdo instrument tjetër i kapitalit të bankës me maturitet të mbetur prej një (1) viti apo më gjatë, me përjashtim të instrumenteve me opsione eksplicite ose të përfshira (ang. embedded) që, në rast se ekzekutohen, do të zvogëlonin maturitetin efektiv të mbetur në më pak se një (1) vit;
 - 1.5. çdo huazim tjetër i siguruar dhe i pasiguruar dhe detyrimet me maturitet të mbetur prej një (1) viti apo më gjatë, përfshirë depozitat me afat, përveç nëse përcaktohet ndryshe në nenet 10 deri 13 të kësaj rregullore.

KAPITULLI IV
FINANCIMI I QËNDRUESHËM I KËRKUAR PËR KALKULIMIN E TREGUESIT NSFR

NËNKAPITULLI I
KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Neni 15

Kalkulimi i shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar

1. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Kapitull, bankat duhet të kalkulojnë shumën e financimit të qëndrueshëm të kërkuar duke shumëzuar vlerën kontabël të kategorive të ndryshme apo llojeve të ndryshme të asetëve dhe zërave jashtë-bilancorë me faktorët RSF në pajtueshmëri me Nënkapitullin II të këtij Kapitulli. Shuma totale e financimit të qëndrueshëm të kërkuar duhet të jetë e barabartë me shumën e shumave të peshuara të asetëve dhe zërave jashtë-bilancorë.
2. Asetet e huazuara nga banka, përfshirë transaksionet e financuara me letra me vlerë, të cilat janë përfshirë në bilancin e gjendjes dhe ndaj të cilave bankat nuk mbajnë pronësinë e përfituesit duhet

të përjashtohen nga kalkulimi i shumës RSF. Asetet e marra hua nga banka, përfshirë transaksionet e financuara me letra me vlerë të cilat nuk janë përfshirë në bilancin e gjendjes por për të cilat bankat mbajnë pronësinë e përfituesit duhet të jenë subjekt i aplikimit të faktorëve RSF sipas Nënkapitullit II të këtij Kapitulli.

3. Asetet të cilat janë dhënë hua nga bankat, përfshirë transaksionet e financuara me letrat me vlerë, ndaj të cilave bankat mbajnë pronësinë e përfituesit, edhe atëherë kur nuk i mbajnë në bilancin e gjendjes, duhet të konsiderohen si asete të ngarkuara (ang. encumbered assets) për qëllime të këtij Kapitulli dhe duhet të jenë subjekt i faktorëve RSF të aplikueshme sipas Nënkapitullit II të këtij Kapitulli. Në rastin e kundërt, asete të tilla duhet të përjashtohen nga kalkulimi i shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar.
4. Asetet që janë të ngarkuara (ang. encumbered) për maturitetin e mbetur kohor prej gjashtë (6) muaj apo më gjatë, duhet t'u aplikohet njëri nga faktorët në vijim: faktori RSF i përcaktuar sipas Nënkapitullit II, të këtij Kapitulli, ndaj atyre aseteve nëse ato do mbaheshin të lira apo faktori RSF që përndryshe është i aplikueshëm ndaj atyre aseteve të ngarkuara, cilido faktor që është më i lartë. E njëjta duhet të aplikohet kur maturiteti i mbetur i aseteve të ngarkuara është më i shkurtër se maturiteti i mbetur i transaksionit që është burim i ngarkesës (ang. encumbrance). Asetet me periudhë të mbetur të ngarkesës (ang. encumbrance period) prej më pak se gjashtë (6) muaj duhet të jenë subjekt i faktoreve RSF të përcaktuar në Nënkapitullin II, të këtij Kapitulli, sikurse të njëjtat asete të mbaheshin të lira.
5. Në rastet kur banka e ri-përdorë apo ri-vendosë si kolateral një aset që është marrë hua, përfshirë në transaksionet e financuara me letrat me vlerë, dhe që është i llogaritur si aset jashtë-bilancor, transaksioni përmes të cilit ky aset është huazuar duhet të trajtohet si i ngarkuar (ang. encumbered) deri në masën që ky transaksion nuk mund të maturoj pa e kthyer banka asetin e marrë hua.
6. Asetet në vijim konsiderohen të jenë të lira nga çdo barrë apo detyrim (ang. unencumbered):
 - 6.1. asetet e përfshira në grup që janë në dispozicion për shfrytëzim të menjëhershëm si kolateral për të përfituar financim shtesë sipas linjave kreditore të zotuara por ende të pafinancuara ndaj bankës ose, nëse grupi i aseteve (ang. pool) është nën operimin e një banke qendrore, sipas linjave kreditore të pazotuara dhe të pafinancuara në dispozicion për bankën. Bankat duhet të supozojnë që asetet në grup janë të ngarkuara (të penguar) në mënyrë që të rritet likuiditeti në bazë të klasifikimit të likuiditetit të përcaktuar në Kapitullin II të Rregullores së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, duke filluar me asetet e papranueshme për rezervën e likuiditetit;
 - 6.2. asetet që banka ka marrë si kolateral për qëllim të zbutjes së rrezikut kreditor në transaksionet e ndërsjellta të marrëveshjes së riblerjes apo transaksioneve të financimit të letrave me vlerë dhe që banka mund t'i shesë.
7. Në rastin e operacioneve të pazakonshme, të përkohshme të kryera nga BQE apo nga një Bankë Qendrore e një shteti të huaj për të pëmbushur mandatin e tyre gjatë një periudhe të stresit financiar të tregut të gjërë apo gjatë rrethanave të jashtëzakonshme makroekonomike, asetet në vijim mund të trajtohen me faktorët RSF të zvogëluar:
 - 7.1. Duke përjashtuar nenin 21 dhe nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 24 të kësaj rregulloreje, asetet e ngarkuara për qëllime të paragrafit 7 të këtij neni;
 - 7.2. duke përjashtuar nenin 21 dhe nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 23 të kësaj rregulloreje, shumat që rezultojnë nga operacionet sipas paragrafit 7 të këtij neni.

8. Lidhur me paragrafin 7 të këtij neni, BQK do të përcaktojë, në marrëveshje me bankën qendrore që është kundërpalë në transaksion, faktorin e RSF që duhet të aplikohet ndaj asetëve të referuara në paragrafin 7, nënparagrafet 7.1 dhe 7.2 të këtij neni. Për asetet e ngarkuara, të referuara në paragrafin 7, nënparagrafin 7.1 të këtij neni, faktori RSF që duhet të aplikohet nuk duhet të jetë më i ulët se sa faktori RSF që do të aplikohet sipas Nënkapitullit II, të këtij Kapitulli, ndaj atyre asetëve sikur të mbaheshin të lira.
 - 8.1. Në rast të aplikimit të faktorit RSF më të ulët në pajtim me paragrafin 8 të këtij neni, BQK do të monitoroj me kujdes ndikimin e këtij faktori të zvogëluar në pozicionet e financimit të qëndrueshëm të bankës dhe nëse është e nevojshme do të ndermerr masa mbikëqyrëse të duhura.
9. Bankat duhet të përjashtojnë asetet e lidhura me kolateralin e pranuar si marginë ndryshuese të postuar në pajtueshmëri me nënparagrafin 5.2 të paragrafit 5 të nenit 10 dhe paragrafin 2 të nenit 24 të kësaj rregulloreje, nga pjesët tjera për kalkulimin e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar në pajtim me këtë Kapitull në mënyrë që të shmanget llogaritja e dyfishtë.
10. Bankat duhet të përfshijnë, në kalkulimin e shumës së financimit të qëndrueshëm të kërkuar, instrumentet financiare, valutat e huaja dhe mallrat (ang. commodities) për të cilat është ekzekutuar një urdhër blerje. Bankat, në kalkulimit të shumës RSF duhet të përjashtojnë instrumentet financiare, valutat e huaja dhe mallrat për të cilat është ekzekutuar një urdhër shitje, me kusht që këto transaksione të mos përfshihen si derivativët apo transaksionet me financim të qëndrueshëm në bilancin e gjendjes së bankës në momentin e shlyerjes.
11. BQK mund të përcaktojë faktorët RSF të cilët do të aplikohen për ekspozimet jashtë-bilancore që nuk janë përcaktuar më këtë Kapitull për të siguruar që bankat të mbajnë shumën adekuate të financimit të qëndrueshëm në dispozicion për pjesën e këtyre ekspozimeve për të cilat pritet të kërkojnë financim gjatë periudhës një (1) vjeçare të treguesit të financimit të qëndrueshëm neto. Për përcaktimin e këtyre faktorëve, BQK posaçërisht do të merr parasysh dëmin material të reputacionit të bankës që mund rrjedhë nga paaftësia e bankës për të siguruar një financim të tillë.

Neni 16

Maturiteti i mbetur i një aseti

1. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë Kapitull, bankat duhet të marrin parasysh maturitetin e mbetur kontraktual të asetëve dhe transaksioneve jashtëbilancore të tyre për të përcaktuar faktorët RSF që duhet të aplikohen në asetet dhe zërat jashtëbilancorë sipas Nënkapitullit II të këtij Kapitulli.
2. Për të kalkuluar maturitetin e mbetur të një aseti, bankat duhet të marrin parasysh opsionet, bazuar në supozimin që lëshuesi ose kundërpala do të ushtrojë çdo opsion për të zgjatur maturitetin e një aseti. Për opsionet që mund të ushtrohen në diskrecion të bankës, banka duhet të merr parasysh faktorët reputacional që mund të kufizojnë aftësinë e saj për të mos ushtuar opsionin, në veçanti pritshmëritë e tregjeve dhe klientëve që banka duhet të zgjatë maturitetin e asetëve të caktuara në datën e maturimit të tyre.
3. Në mënyrë që të përcaktohen faktorët RSF të cilët duhet të aplikohen në pajtueshmëri me Nënkapitullin II të këtij Kapitulli, për kreditë amortizuese me maturitetin e mbetur kontraktual prej një (1) viti apo më shumë, pjesët që maturojnë në më pak se gjashtë (6) muaj dhe midis gjashtë (6) muaj dhe më pak se një (1) vit duhet të trajtohen sikurse maturiteti i tyre i mbetur të jetë prej më pak se gjashtë (6) muaj dhe midis gjashtë (6) muaj dhe më pak se një (1) vit respektivisht.

NËNKAPITULLI II

FAKTORËT E FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM TË KËRKUAR

Neni 17

Faktori RSF prej zero përqind (0%)

1. Asetet në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej zero përqind (0%):
 - 1.1. asetet e lira të cilat i takojnë Nivelit 1 të përcaktuar në Rregullorën e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, pavarësisht nëse ato i plotësojnë kërkesat operationale të përcaktuara në po të njëjtën rregullore.
 - 1.2. të gjitha rezervat që banka i mban në BQK, Bankën Qendrore Europiane apo në Bankën Qendrore të një shteti të huaj, përfshirë rezervat e kërkuara dhe tepricat e rezervave;
 - 1.3. të gjitha kërkesat ndaj BQK-së, Bankës Qendrore Europiane apo Bankës Qendrore të një shteti të huaj me maturitet të mbetur prej më pak se gjashtë (6) muaj.
2. Duke përjashtuar nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1 të këtij Neni, BQK mund të vendosë, në marrëveshje me Bankën Qendrore përkatëse, të një shteti të huaj, të aplikojë faktorin RSF më të lartë ndaj rezervave të kërkuara, marrë parasysh, në veçanti, shkallën në të cilën kërkesa e rezervës ekziston përgjatë horizontit një (1) vjeçar dhe për këtë arsye të kërkojë financim të qëndrueshëm të ndërlidhur.
3. Për subjektet e varura që kanë selinë e tyre kryesore në një shtet të huaj, kur rezervat e kërkuara të Bankës Qendrore janë subjekt i faktorit RSF më të lartë sipas kërkesës për financim të qëndrueshëm neto të përcaktuar në Legjislacionin e atij shteti të huaj, faktori RSF më i lartë duhet të merret parasysh për qellime të konsolidimit.

Neni 18

Faktori RSF prej pesë përqind (5 %)

1. Pjesa e patërhequr e zotimeve kreditore dhe të likuiditetit e përcaktuar në Rregulloren e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, duhet të jetë subjekt i faktorit RSF prej pesë përqind (5%).
2. Për të gjitha setet e netimit të kontratave të derivativëve, bankat duhet të aplikojnë faktorin RSF prej pesë përqind (5%) ndaj vlerës absolute fer të këtyre seteve të netimit të kontratave të derivativëve, bruto nga çdo kolateral i dorëzuar, kur këto sete netimi kanë vlerën fer negative. Për qellime të këtij paragrafi, bankat duhet të përcaktojnë vlerën fer si bruto nga çdo kolateral i dorëzuar apo pagesave të shlyera dhe pranimeve që lidhin me ndryshimet e vlerësimit të tregut të kontratave të tilla.

Neni 19

Faktori RSF prej dhjetë përqind (10 %)

1. Asetet dhe zërat jashtëbilancor në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej dhjetë përqind (10%):
 - 1.1. produktet e financimit tregtar të regjistruara si zëra jashtëbilancorë, siç referohen në Aneksin I të kësaj rregulloreje.

Neni 20

Faktori RSF prej njëzet përqind (20%)

1. Asetet e lira (ang. Unencumbered assets) që i takojnë aseteve të Nivelit 2A të përcaktuar në Rregullorën e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej njëzet përqind (20%), pavarësisht nëse ato i plotësojnë kërkesat operacionale si dhe kërkesat e përbërjes së rezervës së likuiditetit ashtu siç është përcaktuar në rregulloren e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet.

Neni 21

Faktori RSF prej pesëdhjetë përqind (50%)

1. Asetet në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej pesëdhjetë përqind (50%):
 - 1.1. kreditë e siguruara me kolateral dhe të pasiguruara me maturitetin e mbetur prej me pak se një (1) viti dhe me kusht që këto të jenë të ngarkuara (ang. encumbered) për më pak se një (1) vit;
 - 1.2. të gjitha asetet tjera me maturitet të mbetur prej më pak se një (1) viti, përveç nëse përcaktohet ndryshe në nenet 17 deri 20 të kësaj rregulloreje;
 - 1.3. asetet e ngarkuara për maturitetin e mbetur prej së paku gjashtë (6) muaj por më pak se një (1) vit, përveç atëherë kur këtyre aseteve duhet t'u caktohet faktori RSF më i lartë në pajtueshmëri me nenet 22,23 dhe 24 të kësaj rregulloreje, nëse janë mbajtur të lira (ang. unencumbered), në të cilin rast faktori RSF më i lartë duhet të aplikohet sikurse këto asete të mbaheshin të lira.

Neni 22

Faktori RSF prej pesëdhjetë e pesë përqind (55%)

1. Asetet që i takojnë aseteve të Nivelit 2B të përcaktuar në rregulloren e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej pesëdhjetë e pesë përqind (55%), pavarësisht nëse ato i plotësojnë kërkesat operacionale dhe kërkesat e përbërjes së rezervës së likuiditetit të përcaktuar në po të njëjtën rregullore, me kusht që të jenë të ngarkuara (ang. encumbered) për më pak se një (1) vit.

Neni 23

Faktori RSF prej tetëdhjetë e pesë përqind (85%)

1. Asetet dhe zërat jashtë-bilancorë në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej tetëdhjetë e pesë përqind (85%):
 - 1.1. Çdo aset dhe zë jashtëbilancor, përfshirë parane e gatshme, të postuar si margjinë fillestare (ang. initial margin) për kontratat e derivativëve, përveç nëse këtyre aseteve duhet t'u caktohet faktori më i lartë i RSF, në pajtueshmëri me Nenin 24 të kësaj rregulloreje, nëse do të mbaheshin të lira, në të cilin rast duhet të aplikohet faktori më i lartë i RSF sikurse këto asete të mbaheshin të lira;
 - 1.2. kreditë e lira (ang. unencumbered) me maturitet të mbetur prej një (1) viti apo më shumë, me përjashtim të kredive ndaj klientëve financiarë, të cilat nuk janë më shumë se 90 ditë në vonesë;

- 1.3. produktet e financimit tregtar në bilancin e gjendjes, me maturitet të mbetur prej një (1) viti apo më gjatë;
- 1.4. letrat me vlerë të lira (ang. unencumbered securities) me maturitet të mbetur prej një (1) viti apo më gjatë që nuk janë klasifikuar si “të dështuara” sipas Rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor dhe që nuk konsiderohen si asete likuide sipas Rregullorës së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet;
- 1.5. instrumentet e kapitalit të lira (ang. unencumbered) të tregtuara në bursë që nuk konsiderohen ai asete të Nivelit 2B sipas Rregullorës së BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet;
- 1.6. mallrat fizikisht të tregtuara, përfshirë arin, por duke përjashtuar derivativet në mallra.

Neni 24

Faktori RSF prej njëqind përqind (100%)

1. Asetet në vijim duhet të jenë subjekt i faktorit RSF prej njëqind përqind (100%):
 - 1.1. çdo aset i ngarkuar për maturitetin e mbetur prej një (1) viti apo më gjatë;
 - 1.2. çdo aset tjetër përveç atyre të referuara në Nenet 17 deri 23 të kësaj rregulloreje, përfshirë kreditë ndaj klientëve financiare që kanë maturitet të mbetur kontraktual prej një (1) viti apo më gjatë, ekspozimet jo-performuese, zërat e zbritur nga kapitali, asetet fikse, non exchange traded equities, interes i mbajtur, letrat me vlerë të dështuara.
2. Bankat duhet të aplikojnë faktorin RSF prej njëqind përqind (100%) ndaj ndryshimit, nëse është pozitiv, në mes të shumës së vlerave fer në të gjitha setet e netimit me vlerat pozitive fer dhe shumës së vlerave fer në të gjitha setet e netimit me vlerat negative fer të kalkuluar në pajtim me Nenin 6 të kësaj rregullore.
3. Rregullat në vijim duhet të aplikohen gjatë kalkulimit të referuar në paragrafin 2 të këtij neni:
 - 3.1. margjina ndryshuese që bankat kanë pranuar nga kundërpalët e tyre duhet të zbritet nga vlera fer e setit të netimit me vlerën fer pozitive kur kolaterali i pranuar si margjinë ndryshuese kualifikohet si aset i Nivelit 1, të përcaktuar në rregulloren e BQK-së mbi treguesin e mbulimit me likuiditet, dhe kur bankat kanë të drejtë ligjore dhe operationale të ripërdorin atë kolateral;
 - 3.2. të gjitha margjinat ndryshuese të postuara nga bankat te kundërpalët e tyre duhet të zbriten nga vlera fer e setit të netimit me vlerën fer negative.

KAPITULLI V
RAPORTIMI, MASAT PËRMIRËSUESE DHE HYRJA NË FUQI

Neni 25

Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Bankat duhet të dorëzojnë në BQK, format e raportimit të përcaktuara nga BQK, sipas udhëzimeve përkatëse të BQK-së, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas fundit të çdo tremujori.
2. Ankesi I dhe Aneksi II janë pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Neni 26

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Bankat.

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 1 janar 2023.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

ANEKSI I
ZËRAT JASHTËBILANCORË TË FINANCIMIT TREGTAR

1. Rreziku mesatar:
 - 1.1. zërat jashtëbilancorë të financimit tregtar, të tilla si kreditë dokumentare të emetuara dhe konfirmuara;
2. Rreziku mesatar/i ulët:
 - 2.1. zërat jashtëbilancorë të financimit tregtar:
 - 2.1.1. kreditë dokumentare, në të cilat dërgesa ose malli (commodity) shërben si kolateral, si dhe transaksione të tjera të vetë-likuidueshme;
 - 2.1.2. garancitë dhe angazhimet (përfshirë obligacionet e performancës dhe tenderëve dhe garancitë e lidhura me pagesat avans dhe garancitë e ruajtjes/mbajtjes) dhe garancionet që nuk kanë karakteristikat e garancive me karakter të zëvendësimit kreditorë;
 - 2.1.3. letrat kreditore të parevokueshme që nuk kanë karakteristikat e zëvendësuesve kreditorë.

ANEKSI II
LLOJET E DERIVATIVËVE

1. Kontratat e normës së interesit:
 - 1.1. kontrata kundërkëmbimi “swaps” të normës së interesit në një valutë të vetme;
 - 1.2. kontrata kundërkëmbimi bazë ;
 - 1.3. marrëveshje me pajtim paraprak të normës së interesit;
 - 1.4. kontratat e së ardhmes të normës së interesit;
 - 1.5. opsionet e normës së interesit;
 - 1.6. kontrata tjera të natyrës së ngjashme.
2. Kontratat e këmbimit valutor dhe kontratat që kanë të bëjnë me arin:
 - 2.1. kontrata kundërkëmbimi të normës së interesit në valuta të ndryshme
 - 2.2. kontratat me pajtim paraprak të këmbimit valutor;
 - 2.3. kontratat e së ardhmes të valutës;
 - 2.4. opsionet e valutës;
 - 2.5. kontratat tjera të natyrës së ngjashme;
 - 2.6. kontratat e natyrës së ngjashme prej 2.1 deri në 2.5 që kanë të bëjnë me arin.
3. Kontratat e natyrës së ngjashme me ato në nënparagrafet 1.1 deri në 1.5 të paragrafit 1 dhe 2.1 deri në 2.4 të paragrafit 2 të këtij aneksi që kanë të bëjnë me zërat tjerë referentë apo indekset. Kjo përfshinë si minimum të gjitha instrumentet të përcaktuar në pikat 4) deri 7), 9) dhe 10) të Aneksit V të Rregullorës së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, që nuk janë përfshirë ndryshe në pikat 1 ose 2 të këtij aneksi.